




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim (FM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondeve në Mirëbesim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Në tre (3) raste kemi vërejtur që, AKP nuk kishte arritur të arkëtoj të hyrat nga shitja e aseteve me negocim direkt në afatet kohore të përcaktuara me rregullore, vlera e tyre ishte 193,925€.
- B2 Në 25 raste nga të hyrat nga qirat, kanë mbetur obligime financiare të papaguara. Prej tyre 13 raste janë më të vjetra se 5 vjet.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondeve në Mirëbesim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondeve në Mirëbesim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondeve në Mirëbesim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dhe dy (2) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mos respektimi i afatit kohor për pagesën e detyrimit financiar

Gjetja

Neni 8, pika 5 e Rregullores nr. 06/2022 për shitjen direkte të aseteve, përcakton "Nga dita e njoftimit të palës për miratimin përfundimtar të shitjes nga Bordi i Drejtorëve, detyrimi i palës për pagesën e çmimit kontraktues është 60 ditë, me përjashtim të rasteve për të cilat pagesat kontraktohen në faza periodike. Nëse pagesa nuk realizohet brenda afatit të cituar si më sipër dhe pala ofron arsye bindëse lidhur me vonesën, atëherë me pëlqimin e Drejtorit Menaxhues, palës do t'i ofrohet një afat shtesë prej 30 ditësh lidhur me përmbushjen e obligimeve për pagesë. Nëse as pas kalimit të këtij afati nuk realizohet pagesa rasti i përcjellet Bordit për vendimmarrje lidhur me zgjatjen e afatit apo pezullimin e procedurës.

Në tre (3) raste kemi vërejtur që, AKP nuk kishte arritur të arkëtoj të hyrat nga shitja e aseteve me negociim direkt në afatet kohore të përcaktuara me rregullore, ku vlera e tyre ishte 193,925€. Bordi i Drejtorëve kishte marrë vendim për aprovimin e raporteve përfundimtare për shitjen e parcelave gjatë vitit 2019/2020, përderisa pagesat nga ana e blerësve janë bërë në maj/korrik të vitit 2023, që do të thotë se ka pasur vonesë në pagesa nga 32 deri në 40 muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos respektimit të afateve nga palët dhe mos marrja e ndonjë veprimi nga zyrtarët përgjegjës lidhur me zgjatjen e afatit apo pezullimin e procedurës.

Ndikimi

Mos respektimi i afateve ligjore nga palët ndikon që rastet të mbesin pezull dhe mos të merren si të finalizuara, po ashtu dëmtojnë interesat ndaj AKP-së dhe arritjen e objektivave të saj.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negociim direkt si dhe të ndër marrë veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos arkëtimi i të hyrave nga qiratë

Gjetja

Bazuar në kontratat e lidhura për qiranë midis qiradhënësit AKP/AL dhe OE për shfrytëzimin e pronave (objekte, toka) të NSH-ve në likuidim, qiramarrësi është i obliguar dhe pajtohet të paguaj shumat me pagesa brenda 5 ditëve të punës që nga pranimi i një fature. AKP mund të pajtohet me kërkesën me shkrim nga qiradhënësi për të shfrytëzuar afatet e ndonjë pagese sipas kontratës së qirasë në situatën e jashtëzakonshme dhe pajtueshmëri të tilla do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse për këtë pajtohet qiradhënësi.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme për të hyrat nga qiratë, si rezultat i testimit të 28 mostrave kemi vërejtur se vetëm tre (3) raste i kanë kryer obligimet e tyre, përderisa rastet tjera kishin obligime financiare të

papaguara. Prej tyre ka edhe borxhe të pa inkasuara më të vjetra se 5 vjet (13 raste). Për më tepër këto raste të qiramarrësve janë dërguar në përmbarrim dhe në gjykata.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mos marrjen e masave për ndërprerje të kontratës.

Ndikimi

Kjo gjendje rezulton me më pak fonde nga të hyrat dhe ulë mundësin që të realizohen obligimet ndaj kreditorëve apo mbulimin e shpenzimeve për NSH që janë në proces të likuidimit.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollet tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallra dhe shërbime

Gjatë vitit 2023 vlera e pagesave për mallra dhe shërbime të NSH-ve ishte 1,660,991€. Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për ofruesit e shërbimeve për NSH në Likuidim dhe Pagat e punëtorëve për NSH në tranzicion; qiraja, shpenzime për reklamim, shërbime profesionale, mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Çështja A1 - Mangësi gjatë procesit të rekrutimit

Gjetja	Neni 82 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212 parasheh që konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi. Në konkursin e shpallur për Zyrtar Financiar në NSH 'Metaliku' në Gjakovë është kërkuar që personat të cilët përzgjidhen për pozitën në fjalë ndër të tjerash duhet të kenë edhe diplomë të nivelit universitar në ekonomi, financa, administrim biznesi, menaxhim. Po ashtu, neni 3.2 i Rregullores nr. 02/2020 për angazhimin e OSH-ve parasheh që të përdoret procedura e hapur konkurruese për të cilën ftesa publike bëhet në webfaqen e AKP-së. Me rastin e konkursit për OSH/Arkiv, në regjionin e Prizrenit, në konkurs është kërkuar ndër tjera: minimum 2 vite përvojë pune në detyrat e njëjta apo relevante. Personi i përzgjedhur si Zyrtar Financiar në NSH 'Metaliku', nuk posedonte diplomë universitare për ta plotësuar këtë kriter. Ndërsa sa i përket rastit të rekrutimit për pozitën të OSH/Arkivë personi i përzgjedhur ka sjellë dokumente që konfirmojnë vetëm një (1) vit përvojë pune. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes jo adekuate ndaj komisioneve për rekrutim, arsyetimi i të cilëve ishte se kjo ka ndodhur si rezultat i numrit të vogël të aplikantëve.
Ndikimi	Përzgjedhja e punëtorëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit kufizon konkurrencën dhe rrit rrezikun që performanca e tyre të ndikoj në përmbushjen e objektivave të NSH-ve.
Rekomandimi A1	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të përzgjedhë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurset e shpallura publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Shpenzimet komunale

Pagesat për shërbime publike gjatë vitit 2023 ishin 178,674€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefon dhe shërbimet e telekomunikimit) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Çështja A2 - Vonesë në pagesën e shpenzimeve komunale

Gjetja

Sipas nenit 17 të marrëveshjes për shërbimin e mbeturinave - Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për periudhë të caktuar kohore duke filluar nga data 01.03.2023 deri me datën 14.03.2024. Po ashtu, neni 3 i marrëveshjes në këmbim të ofrimit të dakorduar të shërbimeve, ofruesi i shërbimit do të ofrojë shfrytëzuesit faturë në baza mujore për shërbimet e ofruara, ku shfrytëzuesi do të paguajë në afatin brenda 15 ditësh që nga pranimi i faturës.

AKP/Autoriteti i Likuidimit ka Marrëveshje për bashkëpunim me Kompaninë regjionale për pastrimin e mbeturinave për NSH Tregun në likuidim, të lidhur me 14.04.2023 për periudhën një (1) vjeçare. Fatura e lëshuar nga KRM 'Pastrimi' për muajin Maj/2023 e protokolluar nga AKP me datë 09.06.2023 për shërbime të rregullta dhe për shërbimet tjera me kërkesë ishte në vlerë 16,084€, ishte pagur me datë 21.08.2023, duke mbetur e papaguar edhe 32,071€ të borxhit paraprak. Po ashtu, kemi identifikuar edhe një (1) faturë të papaguar për NSH 'ABC Genci' në vlerë 11,680€, ky ishte obligim i vitit 2021 (tatim në pronë) i paraparë të paguhet në shtator të atij viti e që nuk është paguar ende.

Mos kryerja e obligimeve për faturat e pastrimit ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme. Ndërsa sa i përket mos pagesës së faturës së tatimit në pronë kishte mungesë të mjeteve financiare.

Ndikimi

Mos pagesa me kohë e obligimeve, e ekspozon AKP-në ndaj padive, duke shkaktuar kosto shtesë për procedurat të përmbartimit dhe gjykatës, po ashtu ndikon edhe në planin e shpenzimeve dhe pamundëson arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjitha faturat të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim të mos dëmtimit të buxhetit të AKP-së me kosto tjera shtesë përmbartimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për pranimet dhe pagesat e Fondeve në Mirëbesim


Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme;

Tabela 1. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitet 2022 dhe 2023 në Euro (€)


Përshkrimi	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2022	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2022	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2023	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2023
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Gjithsej PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	11,498,674	894,039,696	10,743,398	904,783,094
Të hyrat nga shitja e aseteve	6,152,060	783,723,560	5,408,810	789,132,370
Të hyrat nga qiraja	4,842,279	57,472,003	5,310,881	62,782,883
Interesi i fituar	0	34,844,700	312,448	35,157,148
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	111,501	8,992,465	36,200	9,028,665
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	211,000	211,000	-89,500	121,500
Të hyra tjera	181,834	7,782,769	-235,440	7,547,329
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	0	1,013,200	0	1,013,200
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË				
Gjithsej PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË	30,381,309	728,185,622	10,224,136	738,409,758
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	6,673,827	160,227,434	3,229,677	163,457,111
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	429,900	17,406,257	499,800	17,906,057
Mallra dhe shërbime	1,800,553	24,159,725	1,660,991	25,820,716
Shpenzimet komunale	206,836	3,261,820	178,674	3,440,494
Tatimet	819,098	11,976,922	764,646	12,741,568
Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)	5,366,632	8,490,610	47,226	8,537,836
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	0	45,777,947	0	45,777,947
Të tjera	13,478	871,781	12,393	884,174
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	15,070,985	57,779,385	3,830,728	61,610,113
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	0	398,233,741	0	398,233,741
Gjendja bankare	-18,882,635	165,854,074	519,263	166,373,337

Pranimet/të hyrat kanë të bëjnë me shitjet, qiratë e aseteve të NSh-ve dhe të hyrat tjera. Gjatë vitit 2023 pranimet/të hyrat ishin 10,743,399€, në raport me vitin e kaluar kemi një rënie prej 7%. Ndërsa, pagesat/shpërndarjet gjatë vitit 2023 ishin në vlerë prej 10,224,135€, në raport me vitin e kaluar që ishin 30,381,309€. Kjo rënie ishte për shkak se në vitin 2023 ka pasur shpërndarje më pak se në vitin 2022 të pagesave të 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK, pagesave të kreditorëve të NSH-së si dhe pagesave të Ofruesve të Shërbimeve profesionale.

Grafiku 1. Pranimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2022-2023



Grafiku 2. Pagesat sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2022-2023



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Fondeve në Mirëbesim ka rezultuar me tetë (8) rekomandime. FM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar, ndërsa dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Vendimet e gjykatave/përmbarduesve (depozita dhe taksa)	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga vendimet gjyqësore të paguhen në kohën e duhur dhe brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.	AKP gjatë vitit 2023 nuk ka pasur raste të shpenzimeve shtesë për vendimet gjyqësore.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që mekanizmat e kontrollit të monitorojnë dhe i shtojnë kontrollet tek qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimi i të hyrave të bëhet në kohë.	Raste të ngjashme përsëriten edhe gjatë vitit 2023 në kategorinë e të hyrave/llogarive të arkëtueshme. Referenca B2	Nuk është adresuar

3.	Të hyrat nga shitja e aseteve	Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negociim direkt si dhe të ndërmerrë veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve.	Edhe pse janë ndërmarrë disa veprime për adresim, rekomandimi mbetet i njëjtë. Referenca B1	Nuk është adresuar
4.	Të hyrat nga shitja e aseteve	Bordi i Drejtorëve duhet të forcojë kontrollet e brendshme duke siguruar se procedura për përmbylljen e kontratës të kryhet në afatin kohor të paraparë prej 30 ditësh.	AKP gjatë vitit 2023 nuk kishte ndonjë rast të mos përmbylljes së kontratave brenda afatit të caktuar.	I zbatuar
5.	Të hyrat nga qiraja	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kontrollet janë funksionale me rastin e lidhjes së kontratave, dhe kontratat e identifikuara me gabime përmbajtësore duhet të korrigjohen nga nivelet përkatëse.	Raste të ngjashme nuk janë përsëritur gjatë vitit 2023, gabime përmbajtësore në lidhjen e kontratave.	I zbatuar
6.	Të hyrat nga qiraja	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale dhe çdo ndryshim në strukturën e objektit të dhënë me qira paraprakisht duhet ti paraprij miratimi i Bordit, me qëllimin të menaxhimit të këtyre ndryshimeve në veçanti kur këto rinovime janë objekt i ndryshimit të kontratave.	AKP gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndonjë rast të kërkesave për ndryshime të strukturës së objekteve të marra me qira.	I zbatuar
7.	Mallra dhe shërbime	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kostot e angazhimit sipas rregullores janë duke u zbatuar, duke pas parasysh pagesën e njëjtë për shërbimin e njëjtë.	AKP ka ndërruar rregulloren duke i dhënë mundësi që NSH-të operative ti kalkulojnë vet kostot e NSH-ve	I zbatuar
8.	Shpenzimet komunale	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale duke lidhur me kohë kontratat. Si dhe duhet të sigurojë se para ekzekutimit të pagesës, pranimet e shërbimit janë kontrolluar dhe evidencat janë të plota dhe të sakta duke reflektuar në faturim sipas këtyre evidencave.	AKP gjatë vitit 2023, shërbimet për KRM Pastrimi nuk ka pasur raste të faturuara jashtë kontratës.	I zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. 1995
 No. 1
 Nr. i Fq. 1
 Br. Str. 1
 No. Pg. 1

Data: 22. 05. 2024
 Datum: 22. 05. 2024
 Date: 22. 05. 2024

Pristinë / Pristina

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
 KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**
 Auditore e Përgjithshme
 Zyra Kombëtare e Auditimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE-PRANIMET/DATE-RECEIVED: 22-05-2024

Nr. Org. Org. Jedini Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	621	1

E nderuar znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Arben Limani
 Drejtor Ekzekutiv
 Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data 22 Maj 2024

Tel: +383 (0) 38 500 400
 Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.